



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I MJEKËSISË VETERINARE
DEKANATI

Nr. 213 Prot

Tiranë, më. 01/06/2021

VENDIM DEKANATI

Nr. 10, datë 01.06.2021

**PËR RREGULLOREN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS
NË “SHKENCA VETERINARE”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 808, datë 11.12.2019 “Për disa ndryshime në vendimin 112, datë 23.02.2018, Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 185, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 52, datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, Rregulloren e Programit të Studimeve të Doktoratës në UBT, Dekanati i FMV-së në mbledhjen e tij të datës 01.06.2021,

VENDOSI:

1. Të miratoj Rregulloren e Programit të Studimeve të Doktoratës në “Shkenca Veterinare”;
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Zv. Dekani për Shkencën dhe Projekteve, Drejtuesit e Njësive Bazë në FMV, Komisioni për Dhënie të Gradës Shkencore “Doktor”.





**UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I MJEKËSISË VETERINARE**

RREGULLORE E STUDIMEVE TË DOKTORATËS

E FAKULTETIT TË MJEKËSISË VETERINARE

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në VKM-në 112, dt. 23/02/2018

MIRATOHET

DEKANI
Prof. Dr. Rezart POSTOLI



TIRANË, 2021

PJESA E PARË

PROCEDURAT E ADMINISTRIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e aplikimit

1. Rregullorja e studimeve të doktoratës në FMV administron studimet e doktoratës, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Studimet e doktoratës kanë për qëllim kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese në të gjitha fushat e Shkencës Veterinare, të ofruara pranë Fakultetit të Mjekësisë Veterinare;
2. Rregullorja e studimeve të doktoratës vendos rregullat normative të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në veprimtarinë e saj, ndarjen e përgjegjësisë, pranimin, regjistrimin, kërkimin, të drejtat e detyrimit e studentëve, rregullat për kualifikim, mbrojtjen e tezës dhe fitimin e gradës shkencore “Doktor” si dhe raportet me organet drejtuese përgjegjëse për studimet e doktoratës. Kjo rregullore zbatohet nga njësitë bazë dhe Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore Doktor (KGSHD) në FMV.

Neni 2

Baza ligjore

Rregullorja mbi organizimin e studimeve të doktoratës për përfitimin e gradës shkencore “Doktor” në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare bazohet në:

- Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 112, datë 23. 02. 2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 808, datë 11. 12. 2019 “Për disa ndryshime në vendimin 112, datë 23. 02. 2018;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga

Institucionet e Arsimit të Lartë”;

- Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 185, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”;
- Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 52, datë. 03.12.2015, "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”;
- Statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës;
- Kodi e Etikës së UBT-së.

Neni 3

Objektivat e rregullores

Programi i studimeve të ciklit të tretë “Doktoratë“, në FMV ka si objektiva:

1. Kualifikimin dhe edukimin e kërkuesve në nivel të lartë kërkimor në përputhje me parimet e njohura shkencore dhe etike të UBT-së, të sanksionuara më ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe në VKM-në, 112, dt. 23.02.2018;
2. Kryerjen nga doktorantët të projektit të tyre të kërkimit shkencor dhe mbrojtjen e tij para Jurisë për fitimin e gradës shkencore “Doktor”.

Neni 4

Organizimi i Studimeve të Doktoratës

1. Studimet e doktoratës në FMV ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga FMV dhe kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese, për përgatitjen e tezës së doktoratës, rezultatet dhe mbrojtja e suksesshme e së cilës do të çojë në fitimin e gradës shkencore “Doktor”;
2. Studimet e doktoratës, zhvillohen me kohë të plotë pranë njësive bazë në FMV, ose me kohë të zgjatur në ato raste, kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë, apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar;
3. Kandidati aplikon individualisht në programin e studimit të miratuar në

fushat e kërkimit shkencor, të ofruara nga Fakulteti. Njësia bazënë FMV miraton programet individuale të kërkimit të kandidatëve vetëm për atë fushë të programit të miratuar të doktoratës që ofron;

4. Kur fushat e kërkimit janë të ndërthurura ndërmjet dy ose më shumë njësive bazë në FMV, njëra prej njësive bazë caktohet përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit të kandidatit, në dakordësi ndërmjet tyre;
5. Studimet e doktoratës, organizohen brenda një projekti të madh kërkimor-shkencor e zhvillimor për këto studime dhe realizohen në koordinim me aktivitete të kërkimit të grupeve kërkimore brenda njësive bazë në FMV. Në rastet e aplikantëve me statusin e personelit akademik të brendshëm, studimet e doktoratës mund të mbështeten në burimet e brendshme të Institucionit;
6. Studimet e doktoratës organizohen në fusha/nënfusha kërkimi në “Shkenca Veterinare”. Ato përmbajnë veprimtari kërkimore-shkencore, me qëllim garantimin e formimit në fushën/nënfushën përkatëse të studimit;
7. Studimet e doktoratës, mund të përmbajnë aktivitete të formimit të thelluar teorik, bazuar në rekomandimet përkatëse të udhëheqësit apo grupit kërkimor, për të përvetësuar metodologjitë e kërkimit dhe teknikave operative specifike etj;
8. Numri i doktorantëve përcaktohet nga njësia bazë dhe projekti kërkimor i çdo doktoranti është në vartësi të projekteve kërkimore brenda njësive bazë. Për kryerjen e studimeve të doktoratës, studenti mund të përfitojë edhe financime nga subjekte të tjera, apo dhe të vetëfinancohet;
9. Studimet e doktoratës, zhvillohen në formën e grupeve kërkimore, që drejtohen nga personeli akademik, që ka titullin akademik “Profesor i asociuar” ose “Profesor” dhe mund të udhëheqin, respektivisht, një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë;
10. Ky numër përfshin udhëheqjet që personeli akademik i kategorisë “Profesor” ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, ku ai është i angazhuar;
11. Numri i doktorantëve në përbërje të secilit grup kërkimor, i cili përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar, është:
 - a) jo më shumë se 3 (tre), në rastin e personelit akademik që mban titullin “profesor”;
 - b) jo më shumë se 2 (dy), në rastin e personelit akademik që mban titullin

“profesor i asociuar”;

12. Në rastet kur një pjesë e studimeve të doktoratës, zhvillohen në një institucion të arsimit të lartë të vendeve anëtarë të Bashkimit Evropian, SHBA- ve dhe Kanada, bashkëudhëheqësi në këto vende pritëse mund të jetë edhe me gradën “PhD/Doktor”;
13. Studimet e doktoratës zgjasin të paktën 3 vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në raste të veçanta, për arsye objektive të justifikueshme (sëmundjeve afatgjata apo rrethanave të tjera të paparashikuara), me propozim nga njësia bazë dhe miratim nga KGSHD, afati mund të shtyhet me dy periudha nga 6 muaj;
14. Në rast se dizertacioni nuk paraqitet për fillim procedure të mbrojtjes edhe brenda afatit të tejkujatur (pa justifikim bindës), KGSHD me propozim të njësisë bazë ndërpret vazhdimin e doktoraturës;
15. Në rastet, si p.sh. për shkak të thyerjes së etikës, mungesës së progresit të punës kërkimore në afate, apo ndryshimeve sinjifikative të projektit kërkimor, njësia bazë mund ti propozojë Dekanatit, që kandidati të ndërpresë programin përpara përfundimit, vendim të cilin e miraton Dekani;
16. Programi i studimeve të ciklit të tretë organizohet në mënyrë që të garantojë:
 - a) mundësitë për një kërkim shkencor të pavarur në bashkëpunim me drejtuesin/udhëheqësin dhe në raste të veçanta dhe me kërkues të tjerë;
 - b) pjesëmarrjen aktive në grupe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - c) punën kërkimore, e cila është e lidhur ngushtë me punën e Doktoratës;
 - d) përpilimin e tezës së Doktoratës, bazuar në punën kërkimore-shkencore.
17. Programi i doktoratës duhet të pasqyrojë në mënyrë të detajuar:
 - a) **Planin e kërkimit shkencor** (fusha bazë e kërkimit shkencor, objektivat kryesore të kërkimit, koha dhe vendi i realizimit të kërkimeve metodat bazë që do të përdoren në realizimin e kërkimit etj.);
 - b) **Planin e aktiviteteve krijuese** të studentëve të doktoratës dhe mënyrën e monitorimit të ecurisë së tyre (koha dhe numri i referimeve në njësinë bazë, i botimeve shkencore dhe i pjesëmarrjes në konferenca shkencore, etj.);
 - c) **Planin e angazhimit** të studentëve të doktoratës në aktivitete ndihmëse të procesit.

17. Grada shkencore “Doktor” fitohet pas mbrojtjes me sukses të tezës së dizertacionit në përfundim të programit të studimeve të doktoratës në fushën e “Shkencës veterinare” sipas kriterëve dhe afateve të përcaktuara në legjislacionin e arsimit të lartë dhe në këtë rregullore.

PJESA E DYTË

PROCEDURAT E APLIKIMIT, PËRZGJEDHJES DHE PRANIMIT TË KANDIDATËVE FITUES

Neni 5

Njoftimi për hapjen e pranimeve në studimet e doktoratës

1. Hapja e pranimeve për studimet e doktoratës në FMV, bëhet me urdhër të Rektorit dhe shpallet në mediat elektronike/të shtypit të shkruar, në mjediset e Fakultetit si dhe në faqen zyrtare të UBT-së;
2. Njoftimi përfshin informacionin e mëposhtëm:
 - a. Fushat e studimeve të doktoratës;
 - b. Kuotat e doktoratës për çdo fushë studimi;
 - c. Dokumentacionin e nevojshëm për aplikim;
 - d. Afatin për paraqitjen e aplikimit;
 - e. Kriteret e pranimit.
3. Kandidati përpara se të pranohet në programin e studimeve të doktoratës në “Shkenca Veterinare”, duhet të ketë marrë informacion të detajuar lidhur me:
 - a) kohëzgjatjen e programit të studimit të doktoratës;
 - b) kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojë studenti përpara paraqitjes në provimin e Doktoratës;
 - c) mbështetjen që institucioni dhe udhëheqja i sigurojnë studentit veçanërisht informacionin lidhur me përgatitjen e tezës së Doktoratës për mbrojtje;
 - d) modalitetet e verifikimit të veprimtarisë shkencore, veçanërisht kërkesat lidhur me përgatitjen e tezës së doktoratës, të cilat jepen në fund të kësaj rregulloreje;

e) informacionin që studenti duhet të gjejë në faqen zyrtare të UBT-së.

Neni 6

Kushtet dhe Kriteret e pranimit në studimet e doktoratës

1. Të drejtën e aplikimit për programin e studimeve të doktoratës në “Shkenca Veterinare” e kanë të gjithë kandidatët që kanë përfunduar programin e integruara të studimeve të ciklit të dytë “Mjekësi Veterinare”, sipas parimit të thellimit të studimit në fushë të njëjtë apo të përafërt me studimet e ciklit të dytë dhe kanë fituar diplomën universitare “Master i shkencave”, ose një diplomë ekuivalente me të (si “DIND”);
2. Kandidatët që zotërojnë një Diplomë “Master i Shkencave” ose DND të fituara në institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit (Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit “Fan Noli” në Korçë, fakultete e departamente të ngjashme në Universitetin e Tiranës, Mjekësisë dhe Universitetet e rretheve dhe universitetet homologe të huaja). Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të ekuivalentohen përpara aplikimit, sipas akteve ligjore në fuqi të ministrisë përgjegjëse për arsimin;
3. Kandidatët që kanë mbaruar ciklin e parë me notën mesatare 7 e lart dhe ciklin e dytë të studimeve me notën mesatare 8 e lart;
4. Kandidatët që kanë përgatitur një propozim bindës, bazuar në projektin kërkimor – shkencor në fushën e kërkimit që mbulon njësi bazë, në përputhje me fushat prioritare të zhvillimit kombëtar;
5. Njohje të njërës prej pesë gjuhëve të huaja si anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
6. Kandidati që aplikon për tu pranuar në programin e studimeve të doktoratës në “Shkenca Veterinare” duhet të ketë çertifikimin dhe rezultatin e testeve ndërkombëtare për nivelet e njohjes së gjuhëve të huaja, të cilat i përkasin një periudhe jo më vonë se dy vjet nga koha e lëshimit të tyre;
7. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga pesë gjuhët e lartpërmendura, diploma e fituar i shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj.

Neni 7

Procedura e aplikimit

1. Kandidatët aplikojnë për t'u regjistruar në studimet e doktoratës me dosje

individuale, e cila dorëzohet në sekretarinë e FMV-së dhe duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

- a. Një propozim ku përcaktohet fusha me interes e kandidatit, drejtimi i studimit, departamenti që i drejtohet për ndjekjen e studimeve të doktoratës dhe udhëheqësi shkencor;
- b. Propozimin e përgatitur nga kandidati, për temën e kërkimit/metodologjinë/pritshmëritë, bazuar në projektin kërkimor – shkencor dhe zhvillimit në fushën e kërkimit që mbulon njësi bazë, në përputhje me fushat prioritare të zhvillimit kombëtar, firmosur nga udhëheqësi;
- c. Deklaratë e drejtuesit shkencor për udhëheqjen e studimit të doktoratës, në fushën e përzgjedhur;
- d. Kopje e noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- e. Kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të tretë “Master ekzekutiv“, diplomë specializimi, ose të diplomave ekuivalente me to, shoqëruar me listën e notave ose suplementin e diplomës, nëse kandidati ka të tilla;
- f. Curriculum vitae;
- g. Dëshmitë për specializimet e mëparshme që ndikojnë në kualifikimin pasuniversitar (*nëse ka*);
- h. Dëshmitë për bashkëpunimin me institucionet e tjera shkencore e private (*nëse ka*);
- i. Fotokopje të kartës së indentitetit/pasaportës;
- j. Dy rekomandime të dhëna përkatësisht nga dy “Profesorë” ose “Profesorë të asociuar” të fushës përkatëse ose fushave të përafërta;
- k. Konfirmimin me shkrim, të një punonjësi akademik me titull Profesor ose Profesor i Asociuar (ose gradën doktor të fituar në një Universitet perëndimor), për ta udhëhequr kandidatin si dhe një përrshkrim i përgjithshëm i drejtimit kërkimor që mendohet të ndërmerret”
- l. Një deklaratë ku ai pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare, lidhur me koston e studimeve sipas përcaktimeve të bëra nga instancat e UBT-së;
- m. Dëshmi të gjuhës së huaj, sipas kornizës ligjore në fuqi;

- n. Vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar;
 - o. Mandat për tarifën e aplikimit për konkurim (duke vërtetuar edhe respektimin e afatit)
2. Aplikimet që nuk përmbajnë dokumentet e sipërpërmendura nuk merren në konsideratë;
 3. Dokumentacioni i aplikantit nuk mund të ndryshohet apo plotësohet pas dorëzimit.

Neni 8

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve

1. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga Dekanati i FMV-së, mbi bazën e propozimit të njësisë bazë përkatëse;
2. Vlerësimi i kandidatëve që aplikojnë për të filluar programin e studimeve të doktoratës në “Shkenca Veterinare” në FMV do të bëhet sipas mesatares të notave dhe pikëve të fituara gjatë prezantimit të projektit kërkimor dhe kriterëve të tjera të përcaktuara;
3. Dosja e kandidatit kontrollohet nga zv/dekani i shkencës për plotësinë e dokumentacionit në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje dhe i përcillet Dekanatit;
4. Pranë Dekanatit ngrihet komisioni “*ad-hod*”, me tre deri pesë anëtarë, kryetar i të cilit është Zv/Dekani i Shkencës dhe Projekteve, nëse ka titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar”. Në raste të tjera kryetar i komisionit është një anëtar i Dekanatit me titujt e lartpërmendur dhe Zv/Dekani i Shkencës është anëtar i komisionit “*ad-hod*”;
5. Komisioni *ad hoc* duhet të mbledhet për të bërë vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve, mbështetur në dosjet e aplikimit, jo më vonë se dy javë pas mbylljes së aplikimeve;
6. Komisioni “*ad-hod*” i fakultetit pas seleksionimit, bazuar në dosjen e aplikantit, realizon intervistën me kandidatin, ku mund të diskutohet fusha dhe tema e kërkimit. Komisioni *ad hoc* shpall renditjen paraprake të kandidatëve brenda 5 ditëve pune;
7. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke plotësuar fillimisht nevojat për kualifikimin e personelit akademik të punësuar me kohë të plotë në FMV;
8. Dekanati, brenda dy javësh miraton listat e kandidatëve fitues me udhëheqësit përkatës dhe shpall listën përfundimtare të fituesve dhe jo fituesve, brenda një jave;
9. Kandidati ka të drejtë të ankimojë procedurën e vlerësimit të kandidatëve,

brenda tri ditëve pune nga shpallja e listës paraprake të kandidatëve fitues. Ankimimi bëhet pranë sekretarisë së njësisë kryesore.

10. Dekani shqyrton çdo ankimim dhe i kthen përgjigje zyrtare në përputhje me procedurat administrative, brenda pesë ditëve pune. Dekani shpall listën e përfundimtare të kandidatëve fitues;
11. Renditja përfundimtare e kandidatëve fitues publikohet në faqen zyrtare të UBT-së, si dhe në ambientet e FMV-së;
12. Kandidatët fitues regjistrohen në sekretarinë e FMV-së për një periudhë dy javore nga data e shpalljes së listës së kandidatëve fitues;
13. Në rast se një kandidat tërhiqet ose nuk rregjistrohet brenda afatit të përcaktuar, atëherë ai e humbet të drejtën e studimeve të doktoratës dhe në vend të tij rregjistrohet kandidati vijues në listën përfundimtare brenda një afati tre ditor;
14. Kandidatët atashohen pranë njësisë bazë përkatëse. Dokumentacioni i aplikimit depozitohet në njësinë bazë dhe pasurohet gradualisht me të gjithë dokumentacionin që provon ecurinë e doktorantit;
15. Kandidatët fitues paguajnë tarifën për regjistrim në programin e studimit të doktoratës ku janë shpallur fitues. Kandidatëve jofitues iu kthehet dosja individuale me dokumentet e aplikimit, sipas kërkesës së tyre.

Neni 9

Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve

Në programin e studimit të doktoraturës në “Shkenca Veterinare” pranohen kandidatë që:

1. Kanë përgatitur një propozim bindës, bazuar në projektin kërkimor – shkencor në fushën e kërkimit që mbulon njësi bazë, në përputhje me fushat prioritare të zhvillimit kombëtar;
2. Kandidati duhet të ketë njohuri të thelluara teorike në fushën përkatëse të studimit. Disa nga aftësitë dhe shprehjet bazë që doktoranti duhet të ketë janë:
 - a. të menduarit krijues;
 - b. zhvillimi i sensit kritik lidhur me fushën e kërkimit;
 - c. lidhjet mes fushave të ndryshme të kërkimit;
 - d. aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës kërkimore;
 - e. kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e kërkimit dhe për të propozuar ide të reja në fushën e kërkimit.

Neni 10

Transferimi i studimeve të doktoratës

1. Transferimet lejohen vetëm për studentët që kanë filluar studimet e doktoratës në programe ku fusha e studimit është e njëjtë ose e përafërt me fushën kryesore të kërkimit të programit të studimeve të Doktoratës në FMV dhe vetëm në fillim të vitit akademik;
2. Kandidatët që kërkojnë të transferojnë studimet e doktoratës duhet të përmbushin Kushtet dhe Kriteret e pranimit dhe përzgjedhjes në studimet e doktoratës në FMV;
3. Kandidatët që kërkojnë të transferojnë studimet e doktoratës duhet që vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor ta përfundojnë brenda periudhës së afatit kohor të lejuar të studimeve të doktoratës;
4. Vendimi i transferimit me qëllim vazhdimin e studimeve në programin e studimeve të doktoratës në FMV, i takon komisionit përkatës, të ngritur nga Dekanati.

PJESA E TRETË

REALIZIMI I STUDIMEVE TË DOKTORATËS

Neni 11

Hartimi dhe miratimi i metodologjisë së kërkimit

1. Studimet e doktoratës organizohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, në një nenfusha të ngjashme ose të përafërta kërkimi në **“Shkenca Veterinare”**. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese, të cilat zhvillohen në bashkëpunim të studentit me udhëheqësin shkencor;
2. Studenti, në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor, prezanton planin e zhvillimit dhe metodologjinë e kërkimit, të cilat diskutohen dhe miratohen në njësinë bazë, ku studenti ndjek studimet e doktoratës. Plani i zhvillimit duhet të detajojë etapat e realizimit të kërkimit shkencor dhe realizimit të botimeve dhe referimeve shkencore;
3. **Plani i Zhvillimit për Programin e Doktoratës** (si pjesë e *planit vjetor të studimeve të doktoratës*) i prezantohet departamentit brenda **vitit të parë të studimeve**. Pas diskutimeve dhe reflektimeve të mundshme, plani i zhvillimit të doktoraturës miratohet në departament dhe firmoset nga Drejtuesi i Departamentit. Një kopje e programit arshivohet në dosjen e

doktorantit;

4. Ky plan zhvillimi duhet të përfshijë:
 - a. Formimin e thelluar teorik që duhet të kryejë studenti;
 - b. Kontributin në mësimdhënie pranë njësisë bazë;
 - c. Një përshkrim të plotë të projektit dhe Metodologjinë dhe detyrat e kërkimit;
 - d. Projekt plan - progresin për fazat e zhvillimit të komponentit kërkimor;
 - e. Kontrollin e ecurisë së punës dhe grafikun e zhvillimit të punës për çdo muaj ku specifikohet qartë se ku zhvillohet fizikisht secili proces i parashikuar;
 - f. Ndonjë plan për qëndrimin në universitete të tjera, institucione kërkimore brenda apo jashtë vendit;
 - g. Projekt planin e botimeve dhe referimeve sipas kërkesave për përfundimin e komponentit kërkimor.
5. Raportet e progresit përgatiten nga doktorantët në bashkëpunim me udhëheqësin/t e tyre dhe shqyrtohen dhe miratohen çdo vit akademik në referimet vjetore të doktorantëve në njësinë bazë;
6. Studimet e doktoratës në FMV do të përfshijnë zhvillimin e veprimtarive të ndryshme formuese që do t'i shërbejnë thellimit të njohurive brenda drejtimit të kërkimit shkencor të përcaktuar, përjasjeve kërkimore dhe zhvillimeve të fundit të disiplinës shkencore në drejtimin e fushës përkatëse të doktorantit dhe temës së doktoraturës;
7. Studentët doktorant përgjatë vitit të parë akademik mund të japin provim edhe një lëndë (një praktikë e tillë është e aplikuar në shumicën e universiteteve të Europës), që mund të përcaktohet nga udhëheqësi me dakortësinë e përgjegjësit të departamentit;
8. Doktorantët që frekuentojnë vitin e dytë ose të tretë të studimeve të doktoratës do të angazhohen në aktivitete mësimdhënëse mbështetëse brenda dhe jashtë auditorit (ndjekje dhe/ose drejtim i praktikës mësimore ose profesionale, konsultime/këshillim studentësh);
9. Angazhimi i doktorantëve në aktivitetet mësimdhënëse të sipërcituara kryhet në kuadër të parashikimeve të programit të doktoratës nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të doktoratës dhe sipas nevojave të njësisë bazë;
10. Çdo vit duhet të bëhet vlerësimi i studentit nëpërmjet referimeve të hapura

në njësinë bazë/grupin mësimor-kërkimor. Në çdo rast njësia bazë/grupi jep konkluzionet e vlerësimit, të cilat mund të përfshijnë dhe pezullimin, zgjatjen ose përjashtimin e kandidatit nga Doktorata.

Neni 12

Udhëheqja dhe përkatësia në grupin e kërkimit

1. Puna për kryerjen e tezës së Doktoratës duhet të kryhet nën drejtimin individual të udhëheqësit me titull “Profesor” dhe “Profesor i asociuar”.
2. Njësia bazë mbështetur në propozimet e grupit kërkimor miraton udhëheqësit shkencorë, të aftë për të drejtuar punën kërkimore të doktorantëve, mbështetur në vlerësimin e veprimtarive kërkimore botuese të tyre brenda e jashtë vendit.
3. Udhëheqësi shkencor kryesor dhe udhëheqësi tjetër (kur është rasti i ofrimit të programit të studimeve të Doktoratës nga më shumë universitete) siguron/jnë që studentët e Doktoratës të marrin mbështetje të mjaftueshme dhe udhëzime për të lehtësuar punën e tyre për arritjen e suksesit.
4. Njësia bazë përgjegjëse duhet të përcaktojë menjëherë një udhëheqës të ri (ose dy) dhe t’ia propozojë dekanatit, në rastet kur:
 - a. Udhëheqësi kryesor nuk është në gjendje të vazhdojë mbikëqyrjen e studentit ose kur do të mungojë për një periudhë të konsiderueshme;
 - b. Marrëdhënia student-udhëheqës nuk funksionon mirë dhe duhet të ndryshojë me kërkesë të studentit ose të udhëheqësit të tij;
5. Zëvendësimi udhëheqësit bëhet brenda dhe jo më vonë se viti i dytë i kërkimit shkencor, me qëllim që ecuria e procesit të mos çënohet;
6. Në të gjitha rastet, studenti duhet të ketë vetëm një pikë të identifikuar kontakti, që duhet të jetë udhëheqësi kryesor i tij/saj. Nëse udhëheqësi kryesor nuk është në dispozicion, studenti duhet të dijë se kush do të jetë personi që do ta zëvendësojë;
7. Udhëheqësi dhe studenti duhet të mbajnë kontakte të rregullta. Udhëheqësi është përgjegjës për vazhdimësinë akademiko-kërkimore të studentit dhe duhet të mundësojë pjesëmarrjen e rregullt të tij në grupin kërkimor;
8. Takimet ndërmjet udhëheqësve dhe doktorantëve duhet të jenë të dokumentuara gjatë shqyrtimit të raporteve të progresit në njësinë bazë.

Neni 13

Vlerësimi përpara mbrojtjes përfundimtare të tezës së disertacionit

1. Vlerësimi përfundimtar i studentëve të Doktoratës duhet të bazohet mbi të gjitha në një vlerësim të produktit kërkimor shkencor të tij;
2. Para se të kalohet në Komisionin e Dhënies së Gradës Shkencore Doktor (KGSHD), doktoranti duhet të bëjë në departament referimin e tretë. Ky referim duhet të jetë një përmbledhje e gjithë punës që doktoranti ka bërë dhe për më tepër, si ka pasqyruar (reflektuar) në punimin e tij/saj propozimet e anëtarëve të departamentit, për të cilat ka patur një vendim unanimit;
3. Nëse vlerësimi përfundimtar i departamentit është pozitiv dhe nëse doktoranti ka përmbushur të gjitha detyrimet e tjera atëherë bëhet kompletimi i dosjes dhe i dorëzohet Zv. Dekanit të Shkencës dhe Projekteve për t'u paraqitur në KGSHD. Departamenti, me pëlqimin e doktorantit dhe udhëheqësit shkencor, i propozon KGSHD-së Jurinë për vlerësimin e disertacionit;
4. Nëse njësia bazë jep vlerësim negativ për disertacionin dhe/ose dosjen, kandidati ka të drejtë të riparaqesë disertacionin dhe/ose dosjen të plotësuar pas një periudhe jo më të shkurtër se 3 (tre) muaj;
5. Puna kërkimore-shkencore duhet të paraqitet në formatin e një disertacioni, sipas modelit që i bashkëngjitet kësaj rregulloreje. Disertacioni është pjesë e punës kërkimore - shkencore, me nivel të lartë akademik në lidhje me formulimin e argumenteve të kërkimit, bazën konceptuale, aspektet teorike, metodologjinë, dokumentimin dhe saktësinë e tij, përdorimin e literaturës dhe prezantimin e punës gjatë mbrojtjes para jurisë;
6. Disertacioni duhet të përfshijë kontribute origjinale në zhvillimin e njohurive të reja teorike/aplikative kundrejt disiplinës përkatëse dhe të ketë një standard akademik, i cili të justifikojë publikimin si pjesë e literaturës në fushën përkatëse;
7. Studenti është i detyruar të ruajë të dhënat e kërkimit në përputhje me udhëzimet dhe rregulloren e studimeve të UBT-së, duke disponuar të gjitha fletoret me shënime, që ka mbajtur gjatë kryerjes së fazave të kërkimit;
8. Në publikimet shkencore, që janë pjesë e punës së Doktoratës do të përdoret përkatësia e UBT-së dhe mirëkuptimi/marrëveshja për autorësitë midis studentit, udhëheqësit dhe bashkëpunëtorëve të tjerë po të ketë;
9. Kriteret bazë që duhet të plotësojë studentin përpara mbrojtjes së disertacionit

janë:

- a. Të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, së paku 3 (tre) referime, 2 (dy) nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN;
 - b. Të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore në revista të shkencore, nga të cilët 1 (një) të jetë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të rankuara në Journal Citation Reports ose Scopus, ku është, së paku, autor i dytë;
 - c. të ketë realizuar 3 (tre) referime në njësinë bazë, përveç referimit të parë, që i takon metodikës ose metodologjisë së studimit. Në referimin e tretë, përveç të dhënave të vitit të tretë duhet dhe përmbledhja e rezultateve për të gjithë kërkimin;
 - d. të gjitha referimet dhe botimet duhet të pasqyrojnë aspekte të punës kërkimore që i përkasin zhvillimit dhe realizimit të planit të doktoratës;
 - e. të ketë përgatitur dhe dorëzuar në departament dizertacionin së bashku me një përmbledhje/autoreferatin të miratuara paraprakisht dhe të firmosura nga udhëheqësi shkencor;
 - f. Kandidatët duhet të hartojnë disertacionin në gjuhën shqipe dhe një përmbledhje të tij (2000 – 4000 fjalë) në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, në format të shtypur dhe elektronik, në përputhje me formatin bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
9. Procedura më të detajuara për fitimin e gradës shkencore “Doktor” përcaktohen VKM nr. 112, datë 23.2.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”.

Neni 14

Mbrojtja publike e tezës së Doktoratës

1. Juria cakton datën e mbrojtjes së disertacionit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj;
2. Kandidati duhet të pajisë çdo anëtar të jurisë me një kopje të disertacionit dhe mendimin e përgatitur nga udhëheqësi shkencor;

3. Njoftimi për datën dhe vendin e mbrojtjes së disertacionit bëhet publik nga njësia kryesore;
4. Koha dhe vendi i mbrojtjes publike shpallen të paktën dy javë më parë nga Zv/Dekani i Shkencës dhe Projekteve. Procedura e mbrojtjes së disertacionit para jurisë është publike;
5. Mbrojtja publike kryesohet nga kryetari i Jurisë dhe zhvillohet sipas kësaj procedure:
 - a. Referimi i studentit të Doktoratës, i cili paraqet objektivat dhe rezultatet e punës shkencore gjatë një intervali prej 30-40 minutave;
 - b. Leximi i oponencave;
 - c. Pyetje dhe diskutime nga juria;
 - d. Pyetje dhe diskutime nga të pranishmit. Në këtë rast pjesëmarrësit nga auditori, të cilët kanë dëshirë të komentojnë, duhet të njoftojnë drejtuesin e seancës dhe të bëjnë komente brenda limiteve kohore të përcaktuara nga drejtuesi i seancës;
 - e. Vlerësimi i Jurisë.

Neni 18

Vlerësimi i Jurisë mbi Tezën e Doktoratës

1. Gjatë vlerësimit të tezës juria duhet të marrë në konsideratë raportet e oponentëve. Një vlerësim i përgjithshëm duhet bërë mbi pikat e dobëta dhe të forta, duke përfshirë dhe vlerësimin nëse materiali dhe metoda janë relevante për argumentet e ngritura në tezë, si dhe nëse argumentet dhe konkluzionet e arritura janë të forta;
2. Udhëheqësi mund të thirret në takimin e jurisë me qëllim që të informojë mbi udhëheqjen e kandidatit të Doktoratës dhe të punës së tezës;
3. Juria mund t'i kërkojë kandidatit të Doktoratës të paraqesë materialet e tij bazë, si dhe materialet suplementare për të qartësuar me informacione shtesë;
4. Vlerësimi i juries është i fshehtë dhe bëhet me pikë. Secili anëtar ka në dispozicion 20 pikë për vlerësimin maksimal të kandidatit;
5. Sistemi i vlerësimit të punimit të doktoraturës është:
 - a. Fiton titullin “Doktor” me vlerësim të jurisë “Shkëlqyeshëm” me 95-100 pikë;

- b. Fiton titullin “Doktor” me vlerësim të jurisë “Shumë mirë” me 85-94 pikë;
 - c. Fiton titullin “Doktor” me vlerësim të jurisë “Mirë” me 65-84 pikë;
 - d. Fiton titullin “Doktor” me vlerësim të jurisë “Mjaftueshëm” me 50-64 pikë;
 - e. Nuk Fiton titullin “Doktor” me vlerësimin “Pakalueshëm” me më pak se 50 pikë;
6. Rezultati përfundimtar i vlerësimit pasqyrohet në proces-verbalin e mbrojtjes së doktoratës dhe më pas shpallet nga kryetari.

Neni 19

Raporti i jurisë mbi tezën e Doktoratës

1. Juria harton raportin e vlerësimit dhe ia dërgon Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, i cili, brenda 10 (dhjetë) ditëve, merr vendimin për dhënien e gradës shkencore “Doktor” dhe ia përcjell për procedura të mëtejshme drejtuesit të njësisë kryesore;
2. KGSHD merr vendim për dhënien e gradës shkencore “Doktor” kur:
 - konstaton respektimin e procedurave të ndjekura nga juria;
 - vlerësimi i jurisë është pozitiv.
3. Çdo mospajtim midis anëtarëve të jurisë duhet të deklarohet në raport, së bashku me arsyet;
4. Kur midis anëtarëve të jurisë ka mospajtim mendimesh, rasti i bëhet i ditur KGSHD-së, i cili:
 - a. Merr vendim për të mos patur vlerësim të metejshëm;
 - b. Kërkon sqarime të mëtejshme nga juria;
 - c. Cakton dy ekspertë të rinj;
 - d. Vendos nëse dy ekspertët e rinj do të përfshihen në juri.
5. KGSHD merr vendim për mosdhënien e gradës shkencore “Doktor” nëse vlerësimi i jurisë është negativ;
6. Kur juria konstaton se teza ka mungesa, ajo mund të lejojë që versioni i përmirësuar i tezës të paraqitet vetëm një herë. Juria duhet të komentojë se cilat pjesë të tezës duhen përmirësuar dhe të përcaktojë afatin final për dorëzimin e tezës së përmirësuar në marrëveshje me kandidatin dhe udhëheqësin;
7. Teza e përmirësuar duhet të paraqitet jo më shpejt se 3 (tre) muaj dhe

brenda 6 (gjashtë) muajve.

8. Nëse juria vendos të rrëzoj tezën e përmirësuar ajo nuk rekomandon riparaqitje të së njëjtës tezë për të bërë një vlerësim të ri. Pra në të gjitha rastet, Juria lejon që teza e përmirësuar të paraqitet vetëm një herë.

Neni 20

Marrja e diplomës për gradën shkencore “Doktor”

1. Pas plotësimit të dokumentacionit të dosjes, Dekani me shkresë zyrtare brenda 1 (një) jave e përcjell dosjen tek Dega e Projekteve, Kërkimit dhe Kooperimit Shkencor (Zyrës së Promovimit) të UBT-së dhe kërkon regjistrimin e gradës në regjistrin e UBT-së dhe në atë shtetëror të gradave dhe titujve akademike.
2. Dega e Kërkimit Shkencor të UBT-së, pasi kontrollon ligjshmërinë e dosjes (ku përfshihet edhe kontrolli anti-plagjiaturë), i relatton Rektorit të UBT-së firmosjen ose jo të gradës shkencore ‘Doktor’ dhe kërkon regjistrimin e saj si në regjistrin e UBT-së dhe në regjistrin shtetëror të gradave dhe titujve akademike në Agjensinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (**AKKSHI**) ;
3. Pas regjistrimit në regjistrin shtetëror të gradave dhe titujve akademike, pranë ZSS bëhet regjistrimi i diplomave të Doktoratave, sipas njësave kryesore;
4. Përmbajtja e dokumentacionit të dosjes është e mirë përcaktuar dhe liston një seri dokumentash të organizuara sipas një skede nga Dega e e Projekteve, Kërkimit dhe Kooperimit shkencor të UBT.-së;
5. Një kopje e disertacionit të studentit që ka marrë diplomën “Doktor” depozitohet në bibliotekën e Universitetit Bujqësor dhe një kopje në Bibliotekën Kombëtare;
6. Dosja e plotë e studentit të Doktoratës së bashku me një kopje të tezës së Doktoraturës dhe autoreferatin depozitohen në Degën e Kërkimit Shkencor dhe arshivohet për 5 vjet dhe më pas transferohen në arshivën e UBT-së;
7. Diploma për gradën shkencore “Doktor” nuk lëshohet, pa u depozituar në institucionet e lartpërmendura disertacioni botuar në letër dhe në disk (CD) dhe pa u bërë publik në faqen zyrtare të UBT-së;
8. Dega e Kërkimit Shkencor e UBT-së përgatit diplomën e gradës shkencore “Doktor”, e cila firmoset nga Dekani i njësisë kryesore përkatëse dhe Rektori i UBT- së, dhe tërhiqet në ditën akademike, në përputhje me aktet nënligjore

në fuqi.

Neni 21

Revokimi i gradës “Doktor”

1. Grada shkencore “Doktor” është e revokueshme në çdo kohë dhe në çdo rast kur konstatohet plagjiaturë ose manipulim të dhënash në punimet e kandidatit;
2. Të gjithë palët e përfshira në procesin e studimeve të Doktoratës duhet t'i referohen rregullores së UBT-së mbi etikën në kërkimin shkencor.

PJESA E KATËRT

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I STUDIMEVE TË DOKTORATËS

Neni 22

Administrimi dhe financimi

1. Organet përgjegjëse për organizimin dhe drejtimin e programit të studimeve të Doktoratës janë KGSHD e FMV-së, Zv/Dekani i Shkencës dhe Projekteve, njësia bazë/njësia kryesore, ku është atashuar studenti i Doktoratës;
2. Shpenzimet për kryerjen e Doktoratës planifikohen dhe mbulohen nga projekte të ndryshme kërkimore të mbështetura nga ministria, nga projektet kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare të përfuara nga udhëheqësit shkencorë të doktorantëve për këtë program studimesh, nga tarifa e regjistrimit dhe e shkollimit të kandidatit, nga shërbime për të tretë, që bëjnë njësitë bazë si dhe sponsorizime ose burime të tjera publike e private, apo edhe me vetëfinancim nga doktorantët;
3. Tarifa e studimeve të doktoratës do të jenë përkatësisht 5 mijë për regjistrim dhe 400 mijë lekë për vazhdimin dhe realizimin e doktoratës.

Neni 23

Përgjegjësitë e Zv/Dekanit të Shkencës dhe Projekteve

1. Të ndjekë procedurën e pranimit të dosjeve të kandidatëve për regjistrimin në Studimet e Doktoratës;
2. Të kryejë seleksionimin paraprak të dosjeve dhe të raportojë pranë dekanatit/Dekanit të FMV-së;
3. Të përgatisë dosjet e kandidatëve në aplikim për shqyrtim dhe t'ua dorëzojë

komisionit “*ad-hod*’ pranë Dekanatit;

4. Të relatojë dosjet e percjella nga njësitë bazë me propozimet përkatëse pranë Komisionit të gradës shkencore të FMV-së (KGSHD);
5. Të koordinojë punën e komisioneve “*ad-hoc*”, njësive bazë me KGSHD-në dhe të hartojë materialin përfundimtar për t’u miratuar në dekanat;
6. Të përgatisë listën e kandidatëve fitues;
7. Të grumbullojë ankimmimet e kandidatëve dhe t’i relatojë ato Dekanit;
8. Të kryejë regjistrimin përfundimtar në regjistrin themeltar të Doktoratës për çdo kandidat fitues me udhëheqësin shkencor dhe temën përkatëse;
9. Të ndjekë kualifikimet specifike për çdo doktorant sipas drejtimit të studimit në bashkëpunim me drejtuesit e njësive bazë dhe udhëheqësit shkencore;
10. Të koordinojë punën me drejtuesit e njësive bazë përkatëse dhe të bashkëpunojë me udhëheqësin përkatës të çdo doktoranti për ecurinë e punës gjatë Doktoraturës;
11. Të hartojë grafikun e prezantimeve të punës shkencore të doktorantëve dhe t’i bëjë ato publike në koordinim me drejtuesit e njësive bazë;
12. Të shqyrtojë raportet e progresit të kërkimit të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësi/t kanë kontakt të rregullt me studentët. Kur konstaton probleme i propozon dekanit ndryshimet e nevojshme;
13. T’u bëjë studentëve të njohur të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzime, rregullore etj., që kanë të bëjnë me procesin e fitimit të gradës shkencore;
14. Të kontrollojë plotësimin e kriterëve të dosjes përfundimtare të doktorantit së bashku me disertacionin e përfunduar, si dhe të ndjekë procedurën për miratimin nga dekani;
15. Të përcjellë dhe të paraqesë për miratim dosjen pranë Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në FMV;
16. Të ndjekë dhe të zbatojë kriteret e afateve kohore për përfundimin e Doktoraturës sipas kësaj rregulloreje;
17. Të krijojë një data-base për gjithë veprimtarinë e Doktoraturës, me qëllim që të shërbejë si informacion ndërmjet të tjerave dhe për planifikimin dhe koordinimin e punës shkencore në vazhdimësi në rang fakulteti.

Neni 24

Përgjegjësitë e Njesisë Bazë për Studentët e Doktoratës

Përgjegjësi i njesisë bazë/njësia kryesore, ku atashohet studenti për kryerjen e studimeve të Doktoratës, ka për detyrë:

1. Të kujdeset për çështjet që lidhen me studentët e ciklit të tretë dhe për komunikimin me udhëheqësin dhe Zv/Dekanin e Shkollës së Doktoratës;
2. Të njohë doktorantët e rinj me rregulloret dhe kërkesat e tjera të UBT-së për Programin e Studimeve të Doktoratës;
3. Të diskutojë mbi statet ku duhet të kalojë doktoranti drejt përfundimit të tezës;
4. Të sigurojë që fusha e kërkimit të jetë brenda ekspertizës metodologjike dhe teorike të udhëheqësit;
5. Të sigurojë se njësia bazë ka kapacitetet e mjaftueshme për të udhëhequr doktorantët deri në fund të programit. Nëse udhëheqësi largohet apo mungon për një periudhë mbi tre muaj, njësia bazë duhet të marrë masa për një udhëheqës alternative ose bashkëudhëheqës, të pranueshëm për doktorantin;
6. Të monitorojë progresin e doktorantit, duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me udhëheqësin, si dhe të sigurojë raportimet e rregullta gjatë gjithë periudhës;
7. Të sigurojë një mjedis të përshtatshëm intelektual dhe fizik për të gjithë studentët. Studentët duhet të inkurajohen të marrin pjesë në seminare shkencore dhe t'u krijohen të gjitha mundësitë që të bëhen një pjesë integrale e mjedisit shkencor të njesisë bazë, grupit kërkimor dhe disiplinës;
8. Të zgjidhë problemin, në rast se marrëdhënia udhëheqës/doktorant prishet, dhe të gjejë alternativa të tjera për përmirësim ose zëvendësimin të udhëheqësit.

Neni 25

Përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor

1. Të garantojë se do të zbatojë të gjitha rregullat e udhëheqjes së Doktoratës;
2. Të garantojë se udhëheqja do të kryhet brenda kohës së parashikuar;
3. Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta të kërkimit.

4. Të japi ndihmesën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literatures dhe të burimeve të informacionit, konsulencën për mbajtjen e shënimeve dhe përgatitjen e punimit;
5. Udhëheqësi ka përgjegjësi të ndërgjegjësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës;
6. Të mbajë takime të rregullta me studentin mbi ecurinë e punimit;
7. Në rastet e bashkudhëheqjes, përgjegjësitë duhet të jenë të qarta për të dyja palët dhe ato duhet të mbajnë kontakte të rregullta;
8. Të vlerësojë rregullisht progresin e studentit, duke i kërkuar atij të paraqesë një raport të shkruar dhe të monitorojë punën e tij përkundrejt standardit;
9. Të vetëdijësojë studentin nëse puna e tij është nën standardin e kërkuar dhe të ndër marrë veprimet e duhura mbështetëse;
10. Të ndihmojë studentin në përgatitjen e prezantimeve në seminare ose takime të ndryshme;
11. Të vërtetojë se kandidati ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e jurisë kur ajo e ka rikthyer punimin për riparaqitje;
12. Të nxisë studentin që ai të marrë pjesë në konferenca dhe të botojë pjesë nga kërkimi i tij, duke respektuar marrëveshjen e autorësisë.

Neni 26

Të drejtat dhe detyrat e studentit

1. Kryerja e Doktoratës mund të konsiderohet si një bashkëveprim tre-faktorial: midis njësia bazë përkatës, udhëheqësit dhe studentit. Ndërkohë që njësia bazë dhe udhëheqësi pritet të sigurojnë mjaft forma për mbështetje dhe drejtim, përgjegjësia e fundit për menaxhimin e projektit dhe marjen e gradës “Doktor” i takon kandidatit.
2. Kandidatët duhet të njihen dhe të zbatojnë rregullat, rregulloret e FMV-së dhe kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me doktoratën në UBT.
3. Përmes sesioneve orientuese të mbajtura në departament ose nëpërmjet konsultimeve me udhëheqësin, kandidati, që në fillimet e tij, duhet të familjarizohet shpejt me:
 - a. Natyrën dhe kufizimet e kërkimit të doktoratës;
 - b. Fasilitetet (duke përfshirë këtu mbështetjen për punën në terren, nëse

është e nevojshme), që studentit i vihen në dispozicion në departament, fakultet dhe në Universitet;

- c. Përmasat e projektit të kërkimit, kornizën kohore për përfundimin e tij dhe stadet normale që ndeshen gjatë rrugës;
 - d. Cilësitë dhe aftësitë që pret Fakulteti/Universiteti përmes diplomimit të tij dhe me ndihmën dhe mbështetjen e udhëheqësit të përgatisë një plan për përfundimin e aftësive të reja gjatë rrugës së tij të kualifikimit.
4. Që në stadet e fillimit, studenti duhet të këshillohet me udhëheqësin në intervale të rregullta dhe të përshtatshme kohore, ashtu siç kanë rënë dakord reciprokisht. Kandidati duhet ta informojë udhëheqësin mbi aktivitetin e kërkimit, progresin e tij, botimet dhe probleme të tjera që i kanë dalë;
 5. Në muajt e parë të fillimit të pjesës kërkimore të studimeve të Doktoratës kandidati duhet të dorëzojë për miratim në departament një raport informues për kërkimin, të përgatitur në bashkëpunim me udhëheqësin;
 6. Studenti duhet t'i paraqesë udhëheqësit të tij çdo vit të paktën një pjesë të rëndësishme të punës së shkruar (në formë raporti, drafti të një kapitulli, etj.). Studenti dhe udhëheqësi duhet të bëjnë një vlerësim madhor të punës së kryer të paktën çdo gjashtë muaj.
 7. Studenti mund dhe duhet të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme kërkimore të lidhura ngushtë me fushën specifike, në të cilën ndjek studimet e Doktoratës;
 8. Studentët mund dhe duhet të marrin pjesë në aktivitetet e parashikuara të Doktoratës jashtë punës së tyre kërkimore. Një doktorant duhet të jetë i lirë të marrë pjesë si dëgjues apo si referues në ligjërata, seminare, debate ndërdisiplinare të organizuara në kuadër të programit të studimit të Doktoratës, apo dhe prezantimeve post- doktorale dhe projekteve kërkimore, madje edhe kur këto aktivitete nuk lidhet drejtpërdrejt me interesin e kërkimit të doktorantit;
 9. Studenti mund dhe duhet të angazhohet në mësimdhënie në programet e studimit të ciklit të dytë, p.sh. në seancat e praktikave, seminareve apo si asistentë lektorë, në mbështetje të profesorëve udhëheqës;
 10. Gjatë periudhës për përgatitjen e tezës studenti duhet të ketë parasysh:
 - a) të familjarizohet me literaturën në fushën e tij të veçantë dhe ta vlerësojë atë në mënyrë kritike;
 - b) të formulojë qartë hipotezën e studimit ose një argument tjetër më të përgjithshëm për rezultatet e tij, të mbështetura me komente, me të

dhëna dhe analiza adekuate dhe bashkëkohore;

- c) t'i kushtojnë vëmëndje të veçantë prezantimit përfundimtar të tezës, zakonisht me Power Point. Versioni përfundimtar jo vetëm që duhet të kontrollohet me kujdes për gabimet, por duhet të strukturohet qartë dhe të jetë lehtësisht i kuptueshëm para Jurisë;

11. Gjatë shkrimit të tezës kandidatët duhet të shmangin:

- a) manipulimin e të dhënave, duke paraqitur rezultate që nuk janë marrë asnjëherë;
- b) falsifikimin apo modifikimin e rezultateteve për të konfirmuar hipotezën;
- c) plagjiaturën, duke përfshirë këtu kopjimin direkt të materialeve, përdorimin e të dhënave apo ideve nga njerëz të tjerë, pa përdorur përkatësinë e duhur apo pa i referuar në citimet bibliografike;
- d) përfshirjen e të tjerëve, të cilët në fakt nuk kanë kontribuar në kërkim.

PJESA E PESTË

STRUKTURA E TEZËS SË DOKTORATËS PËR MARRJEN E GRADËS “DOKTOR”

Neni 27

Aspekte të Përgjithshme

- Punimi duhet të respektojë kërkesat e formatit. Nëse punimi nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar ai nuk pranohet derisa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit;
- Në kopertinë duhet të vendoset emri i universitetit, fakultetit, programit të Doktoraturës, titulli i plotë i temës, emri i kandidatit, emri i udhëheqësit shkencor, viti i mbrojtjes;
- Gjatësia e punimit nuk mund të jetë më e vogël se 100 faqe;
- Kopjet e printuara të tezës duhet të jenë në një letër A4, të një cilësie të mirë (21cm x 29.7cm);
- Materiali duhet të shtypet vetëm nga njëra anë e letrës. Teksti duhet të shtypet me hapësirë 1.15 ndërmjet radhëve. Vetëm një lloj shkrimi duhet përdorur. Lloji i shkrimit duhet të jetë Times New Roman. Masa e shkronjës duhet të jetë 13; first line 0.3;
- **Margjinat** për të gjithë tekstin do të jenë:
 - Margjina e sipërme 1”
 - Margjina e poshtme 1”

- Margjina e majtë 1.25”
- Margjina e djathtë 1.25”
- Të gjithë **numrat e faqeve** duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes;
- **Shënimet** duhen të bëhen me shkrim Times New Roman, 12, hapësira *single*;
- **Tabelat** të përfshihen në tekst. Tabelat duhet të vendosen në qendër të faqes, brenda margjinave të caktuara. Çdo tabelë i duhet vendosur një numër referimi që duhet të ndjekë numrin e kapitullit të cilit i përket. Fjala “Tabela”, numri i tabelës dhe legjenda duhet të vendosen në krye të tabelës. Shkrimi duhet të jetë Times New Roman, 12, bold. Nëse tabela vazhdon në faqen tjetër legjenda nuk përsëritet. Nëse një tabelë përmban citate referencat duhet të theksohen;

Ilustrimet dhe diagramat duhet të skanohen dhe të inkorporohen në versionin elektronik të dokumentit. Fjala “Figura”, numri i diagramës që ndjek numrin e kapitullit të cilit i përket dhe legjenda të vendosen poshtë diagramës apo figurës. Shkrimi duhet të jetë Times New Roman, 12, bold;

- **Literatura** e cituar në tekst do të jetë me mbiemër të autorit dhe të tjerë (Brayan *et al*, 2006);
- Krahas materialit të plotë të tezës së Doktoraturës disertanti përgatit një përmbledhje të kësaj teze ose autoreferati në rreth 30 faqe A 5 në 30 kopje. Një kopje i vihet në dispozicion secilit anëtar të Këshillit të Profesorëve, krahas anëtarëve të jurise së vlerësimit të Doktoraturës.

MODELI I TEZËS SË DOKTORATURËS.

- Në faqen e parë shkruhet në pozicionin e mesit dhe me shkrim të qendërzuar (center text): “**Copyright, # I # Emri, Mbiemri i studentit, # Viti**”. (shënim: Shenja # është përdorur për të treguar fillimin e një rreshti të ri).
- Në faqen e dytë në pozicionin e sipërm shkruhet me shkrim të qendërzuar: “**Udhëheqësi i Emri Mbiemri i Studentit vërteton se ky është versioni i miratuar i disertacionit të mëposhtëm:**” dhe më tej vazhdohet në pozicionin e 1/3 të faqes rishkruhet **Titulli i disertacionit** me germa kapitale dhe shkrim 16, Times New Roman. Më poshtë, me hapësirë të trefishtë, shkruhet në të djathtë **Emri i udhëheqësit shkencor** dhe i **bashkudhëheqësit** (nëse ka) dhe firma përkatëse.
- Në faqen e tretë në pozicionin e sipërm, me shkrim të qendërzuar rishkruhet **Titulli i disertacionit** me germa kapitale dhe shkrim 16, Times New Roman. Në pozicionin e 1/3 të faqes shkruhet **Përgatitur nga Grada e mëparshme (shkurtim), Emri Mbiemri i studentit**, më poshtë, me hapësirë të trefishtë, shkruhet me shkrim të qendërzuar teksti: “**Dizertacion i paraqitur në # Fakulteti i _____, # Universiteti Bujqësor i**

Tiranës, # Në përputhje të plotë # Me kërkesat # Për gradën Doktor.
Faqja mbyllet me shkrimin **Universiteti Bujqësor i Tiranës. # Muaji, Viti**
(shënim: Shenja # është përdorur për të treguar fillimin e një rreshti të ri)

- Në faqen e katërt shkruhet **“Dedikim”**, i cili është fakultativ;
- Në faqen e pestë shkruhet **“Mirënjohje/falenderim”**, e cila është gjithashtu fakultative;
- Në faqen e gjashtë shkruhet ky tekst:

Deklaratë mbi origjinalitetin

Emri Mbiemri

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të evidentuara nëpërmjet citimeve.

Të gjitha të dhënat, tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë dhe internetin, janë pranuar në mënyrë eksplicite si të tilla.

Jam i/e vetëdijshëm (vetëdijshme) se në rast të mospërputhjeve, Senati i UBT-së është i ngarkuar të më revokojë gradën “Doktor”, që më është dhënë mbi bazën e kësaj teze, në përputhje me “Rregulloren e Programeve të Studimit të Ciklit të Tretë (Doktoratë) në UBT”.

Vendi, data

Firma

- Në faqen e shtatë jepet **“Përmbajtja e lëndës”** e cila duhet të jetë e detajuar: kapitujt, titujt dhe nëntitujt e çdo kapitulli dhe numri përkatës i faqeve. Në vijim jepet **“Lista e tabelave”** dhe **“Lista e figurave”** e shoqëruar me numrat përkatës të faqeve;
- Më pas vazhdohet me kapitujt e disertacionit: **“Hyrja”**, **“Materiali dhe Metoda”**, **“Rezultatet”**, **“Diskutimet”** (ose **“Rezultatet dhe Diskutimet”**), **“Konkluzione”**, **“Përmbledhje”**, **“Summary”** (një përmbledhje të tij 2000 – 4000 fjalë), **“Literatura”**, **“Aneks”** (fakultative). Çdo kapitull ka çështjet dhe nënçështjet e veta;
- **Lloji i shkrimit** sipas niveleve:
 - 1 **Titulli kryesor** ose Titulli i kapitullit: Times New Roman; Bold; 16, all capital; hanging 0.3; hapësira para dhe pas tij 12;
 - 1.1 **Niveli i parë**: Times New Roman; Bold; 14; Small capital, hanging 0.4; hapësira para dhe pas tij 6;

1.1.1. **Niveli i dytë**: Times New Roman; Bold; 14; hanging 0.5; hapësira para e pas tij 6;

1.1.1.1 **Niveli i tretë**: Times New Roman; Bold dhe italic; 14; hanging 0.6; hapësira para dhe pas tij 6;

- Më tej jepet një **Cv** e shkurtër e autorit, në mënyrë fakultative, e cila nuk duhet të kalojë një faqe.
- Formatimi i Referencave (Literatura)

Citimi i revistave:

Kliem H, Berisha B, Meyer H, Schams D: **Regulatory changes of apoptotic factors in the bovine corpus luteum after induced luteolysis**. *Molecular Reproduction and Development* 2009, **76**(3): 220-230.

Citimi i librave

Lodish HF, Berk A: **Molecular cell biology**: WH Freeman; 2008.

Citimi i kapitujve të librave

Griffiths AJ: **DNA: Structure and replication**. In: *Introduction to genetic analysis*: WH Freeman; 2005: 920-940.

Citimi i tezave të Disertacioneve

Yetim H: **Biochemical and structural alteration of restructured fish muscle as influenced by egg white tumbling and storage time**. PhD Dissertation. The Ohio State University, Colombus, Ohio, USA. 1993.

Citimi i proceedings të botuara

Podgrabinska S, Braun P, Velasco P, Kloos B, Pepper MS, Jackson DG, Skobe M: **Molecular characterization of lymphatic endothelial cells**. *Proceedings of the National Academy of Sciences of the United States of America* 2002, **99**(25): 16069.

Citimi i materialeve të papublikuara

Arat S, Rzucidlo SJ, Stice SL: **Transgenic bovine nuclear embryos from adult somatic cell lines**. *Turk. J. Vet. Anim. Sci.*, In press.

Neni 28

Hyrja në Fuqi dhe Zbatimi i Rregullores

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Dekanati i FMV-së;
2. Kjo rregullore zbatohet për të gjithë studentët që i fillojnë studimet e ciklit të tretë (Doktoratë) pas hyrjes në fuqi të ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” dhe pas miratimit të akteve nën-ligjore, si VKM-112, dhe udhëzime të ndryshme të ministrit përgjegjës për arsimin si dhe të statutit të UBT-së;
3. Ngarkohen për zbatimin e kësaj rregulloreje njësitë bazë, Zv/Dekani i Shkencës dhe Projekteve, Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore të FMV-së.
4. Të drejtën e ndryshimeve në këtë rregullore e ka vetëm Dekanati i FMV-së me propozimet përkatëse të njësive bazë të UBT-së, Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore të FMV-së, konform akteve rregullatore të UBT-së.